



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2904/12 prot.

Datë 09.01.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 24 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09 .01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1374/2023, datë 28.12.2023, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G. *Adresa: Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/1, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shijak.  
*Adresa: Lagjja “Erzen” Shijak.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 28.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1374/2023, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “Blueprint Technologies” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 29 prot., datë 04.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2904/9 prot., datë 08.01.2024 , me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1374/2023, datë 28.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën ardhur me nr. 29 prot., datë 04.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2904/9 prot., datë 08.01.2024, me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1374/2023, datë 28.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të

procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin Nr. 1374/2023, datë 28.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Bashkia Shijak, ka zbatuar vendimin Nr. 1374/2023, datë 28.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

